



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË

Nr. 117 Prot.,

Tiranë, më 03. 09. 2018

**Lënda:** Kërkohet prononcim

**Drejtuar:** Shoqatave të kineastëve shqiptarë

Të nderuar,

Në kuadër të procedurave për zgjedhjen e Këshillave të rinj të Miratimit të Projekteve, ju ftojmë të diskutoni me komunitetin e kineastëve dhe më konkretisht me anëtarët e shoqatës që Ju drejtoni, rreth formës më të mirë të mundshme për strukturimin e KMP-ve që do të funksionojnë pranë Qendrës Kombëtare të Kinematografisë në periudhën Tetor 2018-Tetor 2020.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë, me qëllim përthithjen e opinionve të sa më shumë kineastëve, është disponibël dhe mirëpret sugjerimet e komunitetit të kineastëve, të zyrtarizuara nëpërmjet shoqatave lidhur me argumentet e mëposhtme:

1. Anëtarët e KMP-ve mund të jenë edhe personalitete apo profesionistë të fushës të huaj? PO/JO

Në rast se përgjigja do të jetë PO, atëherë duhen zgjidhur dy probleme:

- mbulimi i kostos së udhëtimit dhe akomodimit kur anëtari i KMP është i huaj;
- përkthimi i skenarëve në gjuhën angleze.

***Lutemi argumentimin dhe opsionet Tuaja.***

2. A duhet bërë vlerësimi i projekteve me pikë? PO/JO

***Lutemi argumentimin dhe opsionet Tuaja.***

3. A mendoni që janë të rëndësishëm dhe duhet të përfshihen në vlerësimin që anëtarët e KMP-ve do t'i bëjnë projekteve filmike, elementët e mëposhtëm:

I. Cilësia e filmit të mëparshëm të regjisorit, që përbëhet nga këto elementë:

- a. Audiencia në salla në kinematë shqiptare;
- b. Pjesëmarrja në festivale të filmit të mëparshëm;
- c. Çmimet që ka fituar filmi i mëparshëm.

*Sa % të kuotave në vlerësimin e çdo anëtari të KMP duhet të meritojë secili nga elementët e mësipërm?*

II. Cilësia e skenarit konkurrues.

- a. Konfirmohet se skenari ka fituar zhvillim projekti në Programin Media;
- b. Konfirmohet se skenari është selektuar në një workshop për zhvillim skenari;
- c. Konfirmohet se skenari ka fituar një çmim në vlerë monetare;
- d. Konfirmohet se skenari ka fituar një çmim honorifik.

*Sa % të kuotave në vlerësimin e çdo anëtari të KMP duhet të meritojë secili nga elementët e mësipërm?*

III. Cilësia e projektit konkurrues.

- a. Konfirmohet se projekti ka fituar të drejtën për të marrë pjesë në një forum ndërkombëtar;
- b. Konfirmohet se projekti është vlerësuar me çmim në një forum ndërkombëtar;
- c. Konfirmohet se projekti është vlerësuar me çmim financiar në një forum ndërkombëtar.

*Sa % të kuotave në vlerësimin e çdo anëtari të KMP duhet të meritojë secili nga elementët e mësipërm?*

IV. Bashkërodhimi që ka siguruar projekti në momentin e aplikimit:

- a. Konfirmohet se projekti ka siguruar financimin nga fonde publike të huaja;
- b. Konfirmohet se projekti ka siguruar fonde të tjera të besueshme alternative.

*Sa % të kuotave në vlerësimin e çdo anëtari të KMP duhet të meritojë secili nga elementët e mësipërm?*

V. Projekti duhet të gëzojë avantqazh (pasi garanton sukses paraprak) nga përfshirja në të e profesionistëve që i janë bashkëngjitur si më poshtë:

- a. Drejtor fotografie të nivelit të lartë;
- b. Kompozitor të nivelit të lartë;
- c. Aktorë të nivelit të lartë kombëtar, apo ndërkombëtar.


*Sa % të kuotave në vlerësimin e çdo anëtari të KMP duhet të meritojë secili nga elementët e mësipërm?*

Të nderuar zotërinj,

Qendra Kombëtare e Kinematografisë, mirëpret prononcimet Tuaja lidhur me sa më sipër. Shprehim bindjen se opinionet Tuaja do të ndihmojnë për të strukturuar më mirë përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillave të rinj të Miratimit të Projekteve, si dhe dhe mënyrën e funksionimit të tyre.

Lutemi përgjigje zyrtare me propozime të argumentuara nga ana Juaj, brenda datës 10 Shtator 2018.

Ju falënderoj për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.

**KRYETARI**  
  
**Ilir BUTKA**

